

## KONTRATË PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT TV NË PLATFORMËN OTT

Sot me datë \_\_\_\_\_, lidhet marrëveshja ndërmjet palëve si më poshtë vijon:

Shoqëria Digicom sh.p.k, me seli në Rruga Papa Gjon Pali II, ABA Business Center, Tiranë, Shqipëri, identifikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Shqipëri me numër Nipt-i: L42018012R, i përfaqësuar nga administratori i shoqërisë, z. Thoma Zbogo, i përfaqësuar nga agjenti i shitjes \_\_\_\_\_, ku si më poshtë do të quhet "Digicom".

Dhe

\_\_\_\_\_, i lindur në \_\_\_\_\_ me datë \_\_\_\_\_, mbajtës i kartës së identitetit me numër \_\_\_\_\_, me adresë Rr. \_\_\_\_\_, Tiranë, Shqipëri, ku më poshtë do të quhet "Pajtimtari"

### BAZA LIGJORE

Kjo Kontratë hartohet në zbatim të:

1. Ligji Nr. 97/2013, "për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
2. Ligji Nr.9902 datë 17.04.2008 "Për Mbrojtjen e Konsumatorëve" i ndryshuar.
3. Ligji Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
4. Ligje dhe akte nën ligjore që rregullojnë këtë marrëdhënie në Republikën e Shqipërisë.
5. Termave të përgjithshme të Kontratës së Pajtimtari për lidhjen dhe aksesin në rrjetin publik të komunikimeve elektronike.

### TERMAT DHE KUSHTET E KONTRATËS

#### NENI 1

##### OBJEKTI

1. Ofrimi i produktit për Pajtimtarin kundrejt blerjes me pagesë të abonimit, sipas kategorisë së përzgjedhur prej tij për një afat kohor, në përputhje me kushtet dhe termat e përoaktuara në këtë kontratë.

#### NENI 2

##### PËRKUFIZIMET

1. **Kontratë:** Është akti shkresor, i cili nënshkruhet nga palët dhe e bën marrëveshjen mes tyre të jetë e lidhur me formë të ligjshme me një afat minimal 12 muaj.
2. **Data e hyrjes në fuqi:** Data e hyrjes në fuqi të kontratës është data kur Pajtimtari kryen pagesën fillestare.
3. **Palët:** Subjektet kontraktore të kësaj kontrate janë Digicom dhe Pajtimtari.
4. **Pikë e Autorizuar Shitjeje:** Janë të gjitha pikat tek të cilat ofrohen produktet dhe shërbimet e Digicom kundrejt çmimeve zyrtare të këtij të fundit, ku mund të nënshkruhet një kontratë në emër të Digicom dhe/apo për llogari të Digicom-it.
5. **Digicom Online:** Është dyqani elektronik në faqen zyrtare të Digicom-it, në linkun: <https://digicom.al/>.
6. **Pajtimtar:** Janë të gjithë individët, shtetas shqiptarë që kanë mbushur 18 vjeç në çastin e blerjes, që disponojnë një kartë ID ose pasaportë, si dhe personat fizikë dhe juridikë që disponojnë një Nipt dhe lidhin kontratë me Digicom, për të bërë të mundur përfitimin e shërbimit televiziv OTT, vetëm për përdorim vetjak pa të drejtë rishpërndarjeje, duke pranuar kushtet e kësaj kontrate. Abonimi kryhet me anë të përzgjedhjes së një pakete që përmban një paketim të caktuar kanaleve TV.
7. **Produkt:** Janë programe/kanale televizive dhe jotelevizive të ofruara nga Digicom, ndaj çdo përdoruesi të një abonimi përkatës.
8. **Anulimi/përfundimi i abonimit:** Koha dhe gjendja kur shërbimet në të cilat Pajtimtari ka pasur

akses janë anuluar/përfunduar, dhe nuk mund të përfitohet më shërbimi pa riabonim.

9. **Shërbimi televiziv OTT**: Është transmetimi i produktit përmes internetit në çdo rrjet mobil apo wifi brenda territorit të Shqipërisë dhe i disponueshëm në pajisjet smart TV Android, smartphone dhe tablet.

### NENI 3

#### KOHËZGJATJA

1. Kontrata e Pajtimtimit për ofrimin e abonimit në platformën OTT është për një periudhë kohore 12 (dymbëdhjetë) muajsh.
2. Efektet ligjore të kësaj kontrate fillojnë nga momenti kur Pajtimtari kryen pagesën sipas Nenit 4, tabela 1 dhe aktivizon shërbimin OTT.
3. Pas përfundimit të periudhës së abonimit prej 12 muajsh, nëse Pajtimtari nuk njofton me shkrim 30 (tridhjetë) ditë para për mbylljen e kontratës, ajo do të rinovohet automatikisht për një periudhë të përcaktuar, me të njëjtat kushte dhe terma të përcaktuara në kontratë.

### NENI 4

#### TARIFAT DHE PAGESAT

1. Tarifat për produktin ose/dhe pajisjen e zgjedhur nga Pajtimtari janë sipas tabelës nr. 1 në këtë dispozitë të kontratës.
2. Për muajin e parë të aktivizimit të shërbimit OTT, faturimi do të kryhet sipas tarifave të mëposhtme:
  - a. Nga data 1 deri më 15 të muajit aktual, faturimi do të jetë në vlerën 100 lekë.
  - b. Nga data 16 deri më 31 të muajit aktual, faturimi do të jetë në vlerën 0 lekë.
  - c. Për paketat RTSH dhe EBU, faturimi do të jetë 0 lekë për muajin e aktivizimit.
 Pagesa e faturës së shërbimit do të shlyhet sipas afateve të përcaktuara në kontratë, por jo më vonë se fundi i muajit nga data e lëshimit të faturës.
3. Pajtimtari detyrohet të paguajë tarifën e abonimit brenda datës 30 (tridhjetë) të muajit të marrjes së shërbimit. Pas kalimit të këtij afati, shërbimi do të ndërpritet. Pagesën mund ta kryejë në pikat e shitjes së dyqanave Digicom apo nëpërmjet palëve të treta që Digicom bashkëpunon, siç janë institucionet financiare bankare dhe jo bankare.
4. Mosmarrja e faturës nuk e qiron pajtimtarin nga detyrimi për të paguar brenda kohës së përcaktuar.
5. Datë pagesë do të konsiderohet:
  - a. Data e caktuar në deklaratën e pagesës, kur pagesa bëhet në lek në llogarinë bankare të operatorit ose përfaqësuesve të saj të autorizuar për të mbledhur pagesat.
6. Tarifat e përcaktuara nga ky nen, janë përcaktuara në tabelën Nr. 1 të këtij neni.
7. Shërbimet e pakatave rintransmetuese të Tv në platformën OTT janë si më poshtë:

Tabela Nr. 1

| Paketat        | Modeli i TV                               |                                           |                                            |
|----------------|-------------------------------------------|-------------------------------------------|--------------------------------------------|
|                | TV Android <input type="checkbox"/>       | Për çdo TV <input type="checkbox"/>       | Çmim STB                                   |
|                | 3 APP (TV, Tablet, Smartphone)            | 1 STB-1 APP (TV, Tablet, Smartphone)      | 6400 Lekë <input type="checkbox"/>         |
|                | Afati i kontratës                         |                                           |                                            |
|                | 12 Muajore                                |                                           |                                            |
|                | Detajet e pagesës                         |                                           |                                            |
|                | Me këste muajore <input type="checkbox"/> | 6 muaj parapagim <input type="checkbox"/> | 12 muaj parapagim <input type="checkbox"/> |
| Pagesë Muajore |                                           |                                           |                                            |
| Digi TV        | 200 lekë                                  | <input type="checkbox"/>                  |                                            |
| Kanalet RTSH   | 50 lekë                                   | <input type="checkbox"/>                  |                                            |
| Kanalet EBU    | 50 lekë                                   | <input type="checkbox"/>                  |                                            |

## NENI 5

### TË DREJTAT DHE DETYRIMET E DIGICOM

1. Para nënshkrimit të kësaj kontrate, Digicom është i detyruar të njoftojë Pajtimtarin mbi kushtet e përgjithshme: mënyrën e dhënies së shërbimit, çmimi, etj., rregullat e aplikuara për kryerjen e pagesave për blerjen e abonimeve të Digicom. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Pajtimtari deklaron dhe pranon se ka marrë të gjithë informacionin e plotë mbi kushtet e përgjithshme dhe se i kupton dhe i pranon ato..
2. Digicom garanton se do të ofrojë për Pajtimtarin një shërbim cilësor pa ndërprerje, për sa kohë që kjo do të jetë e mundur teknikisht për gjithë zonën e mbulimit. Shërbimet mund të ndërpriten për shkak të forcave madhore, mosfunksionimit të përkohshëm të rrjeteve celulare apo Wi-Fi të tërësive, mirëmbajtjes periodike të sistemit, përmirësimeve/përditësimeve në sistem, si dhe përmirësimeve të cilësisë së shërbimeve televizive dhe shërbimeve të tjera të ngjashme me to, me qëllim ofrimin e një cilësie më të mirë të shërbimit. Në rast të ndërprerjes së sinjalit apo shërbimit nga rrjeti Digicom, Pajtimtari do të vihet në dijeni për shkaqet e këtyre ndërprerjeve.
3. Digicom detyrohet të shqyrtojë në një kohë të përshtatshme çdo ankesë të Pajtimtarit, që ka të bëjë me shërbimin e ofruar, në përputhje me afatet e përoaktuara në nenin 10.2 të kësaj Kontrate
4. Digicom mund të ndryshojë përmbajtjen e programeve të tij gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate, pezullojë përkohësisht kanale të oaktuara, sipas politikave dhe programacionit që vendos Digicom, kontratatave me palët e treta, detyrimeve që rrjedhin nga të drejtat e ritransmetimit, detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve të autoriteteve monitoruese të mediave, etj. Këto ndryshime, përveç ndërprerjeve të përkohshme që rrjedhin nga të drejtat e transmetimit, i bëhen me dije paraprakisht Pajtimtarit në faqen zyrtare të Digicom, dhe ky i fundit zgjedh vetë nëse dëshiron të kryejë rinovimin ose jo të kësaj Kontrate në vijim. Në asnjë rast, klienti nuk mund të pretendojë likuidim dëmsh në rastet e përmendura më sipër.
5. Digicom rezervon të drejtën e ndryshimit në mënyrë të njëanshme të tarifave, në varësi të ndryshimeve të mundshme ligjore, ekonomike, politikave të tij, marrëdhënieve me palët e treta, dhe ofertave sezonale. Pas përfundimit të vitit të parë të abonimit, këto ndryshime i bëhen me dije paraprakisht Pajtimtarit dhe ky i fundit zgjedh vetë nëse dëshiron të kryejë rinovimin ose jo të kontratës me pagesa mujore për blerje abonimi.

## NENI 6

### TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E PAJTIMTARIT

1. Pajtimtari ka të drejtë të përdorë shërbimin OTT të ofruar nga Digicom në çdo rrjet dhe të pa kushtezuar me kontratë interneti.
2. Pajtimtari merr përsipër të mbrojtë, kufizojë dhe kontrollojë personat nën 18 vjeç që përdorin abonimin e bërë prej tij, nga aksesit i programeve që ofron Digicom. Pajtimtarit i ofrohet ndihmë për produktin, në lidhje me përdorimin e programeve të kufizuara me kodim, vetëm pranë pikave të autorizuar të Digicom ose nëpërmjet kanaleve online të Digicom, pasi ky i fundit ka paraqitur letërnjoftimin personal që provon se Pajtimtari ka mbushur moshën 18 vjeç.
3. Në rastin e plotësimit të kësaj kontrate Online, Pajtimtari është i detyruar të japë e-mail-in (*adresën personale të postës elektronike*) personal aktiv, tek i cili Digicom i dërgon kodin e autorizimit. Digicom nuk mban përgjegjësi në rast se adresa e-mail nuk është e saktë dhe Pajtimtari nuk e ka marrë kodin e autorizimit.
4. Pajtimtari bie dakord të respektojë afatet e pagesave mujore. Në rast se këto afate nuk zbatohen, atëherë me pranimin/nënshkrimin e kësaj Kontrate, Pajtimtari i jep miratimin Digicom që të ndërpresë shërbimin.
5. Në rast se pas kryerjes së pagesës, Pajtimtari nuk përfiton shikueshmërinë e kanaleve të Digicom sipas produktit të përzgjedhur prej tij, Pajtimtari mund të kontaktojë menjëherë Digicom. Kontaktet përkatëse për ndihmën ndaj Pajtimtarit gjenden në faqen zyrtare [www.digicom.al](http://www.digicom.al).
6. Pajtimtari ka të drejtë të marrë shërbimin e programacionit që ka lidhur kontratën nëpërmjet log-in në aplikacion ose nëpërmjet pajisjes STB të vendosur në dispozicion nga Digicom.

## **ENI 7**

### **FORA MADHORE**

1. Digicom nuk mban asnjë përgjegjësi në rast se mospërbushja e kushteve të kësaj kontrate ka ardhur si pasojë e një force madhore.
2. Konsiderohen force madhore: lufta (e shpallur ose jo), trazirat, sabotimi, fatkeqësitë natyrore, tërmetet, shpërthimet, zjarri, embargot tregtare, grevat, aktet e autoriteteve shqiptare apo të huaja me fuqi ekzekutive, shkeljet e ligjeve nga ana e autoriteteve shtetërore apo personave të tjerë që ushtrojnë aktivitet në fushën televizive.
3. Digicom do të bëjë të gjitha përpjekjet e mundshme, edhe në raste të force madhore, që t'u sigurojë shërbim përdoruesve sipas kësaj kontrate.

## **ENI 8**

### **KONFIDENCIALITETI DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE**

1. Asnjë informacion i lidhur me kontratën num mund të bëhet publik pa miratimin e palës tjetër, përveç rasteve të përcaktuara nga ligji.
2. Pajtimtari ka të drejtën të korrigjojë të dhënat e tij personale, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Pajtimtari jep pëlqimin për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

## **ENI 9**

### **LIGJI I APLIKUESHËM**

1. Kjo kontratë i nënshtrohet legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë. Palët bien dakord që çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me vlefshmërinë, interpretimin apo zbatimin e marrëveshjes, të zgjidhet në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

## **ENI 10**

### **TË NDRYSHME**

1. Digicom rezervon të drejtën e ndryshimit të dispozitave të kësaj kontrate në zbatim dhe/ose në përputhje me ndryshime të mundshme në legjislacionin në fuqi apo për shkak të ndryshimit të rrethanave ekonomike. Në raste të tilla, Digicom duhet të bëjë njoftim paraprak publik 30 (tridhjetë) ditë para kryerjes së këtyre ndryshimeve. Këto ndryshime i bëhen me dlijë paraprakisht Pajtimtarit dhe ky i fundit zgjedh vetë nëse dëshiron të kryejë rinovimin ose jo të kësaj Kontrate.
2. Ankimimet në lidhje me abonimin, kur këto kanë të bëjnë me Digicom, do të shqyrtohen brenda një afati kohor prej 72 orësh nga depozitimi i ankesës.
3. Problemet që vijnë për shkak të marrëdhënies pajtimtar me palët e treta nuk janë përgjegjësi e Digicom-it.
4. Deklarim dhe firma e Pajtimtarit:
  - a. Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se kam mbushur moshën 18 vjeç, dhe se i kam kuptuar tërësisht e bie dakord plotësisht me të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë e sipërpërmendura të kësaj marrëveshjeje.
  - b. Deklaroj vlefshmërinë dhe vërtetësinë e të dhënave të plotësuar nga unë në këtë kontratë, në pjesën "Informacione mbi Pajtimtarin".

## **PALËT**

**Përfaqësuesi i Digicom**  
**(Emër Mbiemër Firmë, Vulë)**

**Pajtimtari**  
**(Emër Mbiemër Firmë)**